

NJË VËSHTRIM MBI NDRYSHIMET E REKOMANDIMIT 8 DHE DOKUMENTIT TË PRAKTIKAVE MË TË MIRA TË FATF GJATË VITIT 2023

Përgatitur nga:



European Center for
Not-for-Profit Law

Përkthyer në shqip nga:



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Një Vështrim mbi Ndryshimet e Rekomandimit 8 dhe Dokumentit të Praktikave më të Mira të FATF gjatë Vitit 2023 përshkruan ndryshimet e reja të FATF mbi Rekomandimin 8, Shënimin e tij Interpretues dhe Dokumentin e Praktikave më të mira, të cilat kanë ndodhur gjatë vitit 2023. Ai thekson fokusin kryesor të Rekomandimit 8 nga perspektiva e Organizatave Jofitimprurëse, duke analizuar se si dhe pse rekomandimi duhet të interpretohet përmes një vëzhgimi kritik. Ky vështrim ofron paragrafë me informacion të dobishëm për autoritetet përgjegjëse, bankat dhe palët e tjera të interesit.

Një Vështrim mbi Ndryshimet e Rekomandimit 8 dhe Dokumentit të Praktikave më të Mira të FATF gjatë Vitit 2023 është përgatitur nga Qendra Evropiane për Ligjin e Organizatave Jofitimprurëse (ECNL), në dhjetor 2023.

Të gjitha të drejtat e rezervuara © 2023 ECNL



Dokumenti është përkthyer dhe përshtatur në gjuhën shqipe nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, janar 2024.



I. Hyrja

[Rekomandimi 8 \(R8\)](#) i rishikuar dhe Shënimi i tij Interpretues do t'u kërkojnë vendeve të mbrojnë shoqërinë civile nga abuzimi me financimin e terrorizmit nëpërmjet zbatimit të masave të forcuara, bazuar në rrezik. Ndryshimet e reja të miratuara sqarojnë se masat e fokusuara, proporcionale dhe të bazuara në rrezik janë në thelb të një qasjeje efektive për identifikimin, parandalimin dhe luftimin e abuzimit terrorist të shoqërisë civile. Kur zbatohen siç duhet, ato janë krijuar për të mbrojtur integritetin e sektorit të shoqërisë civile pa ndërprerë apo dekurajuar në mënyrë të padrejtë aktivitetet legjitime të shoqërisë civile.

Ndër ndryshimet e shumta të R8, disa përditësime kryesore përfshijnë:

- Tani, R.8 kërkon që vendet të identifikojnë periodikisht organizatat që përfshihen në përkufizimin funksional të Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF) të sektorit jofitimprurës (OJF) dhe të vlerësojnë rreziqet e financimit të terrorizmit që i paraqiten sektorit. Me fjalë të tjera, R8 nuk zbatohet për të gjithë sektorin e organizatave që punojnë në fushën e shoqërisë civile: por vetëm për ato që përfshihen në përkufizimin e FATF. Midis tyre, vetëm një pjesë e vogël mund të përballet me një “rrezik të lartë” të abuzimit terrorist.
- R.8 kërkon që vendet të kenë masa të fokusuara, proporcionale dhe të bazuara në rrezik për të adresuar rreziqet e identifikuara. Një qasje e bazuar në rrezik është thelbësore duke pasur parasysh diversitetin brenda sektorit vendas të shoqërisë civile dhe shkallët e ndryshme të rrezikut të abuzimit me të cilin përballen. Shumë organizata të shoqërisë civile mund të kenë tashmë masa të duhura vetërregulluese dhe masa lidhur me kontrollin e tyre të brendshëm për të zbutur rreziqet e financimit të terrorizmit, të tilla që autoritetet kombëtare nuk kanë nevojë të marrin masa shtesë.
- Vendet duhet të kenë parasysh ndikimin e mundshëm të masave në aktivitetet legjitime të shoqërisë civile. Detyrimet joproporcionale ndaj organizatave mund të pengojnë aktivitetet e tyre legjitime dhe shërbimet e ofruara, shumë të nevojshme, duke ndikuar kështu në të drejtat ekonomike dhe të drejtat e tjera të njeriut. R8 sqaron se vendet duhet të sigurojnë mbikëqyrjen ose monitorimin e organizatave të shoqërisë civile, por ato nuk duhet t'i caktojnë dhe mbikëqyrin ato si subjekte raportuese ose t'u kërkojnë atyre të bëjnë kujdesin e duhur ndaj klientit.

Siç vë në dukje FATF, rishikimi i Rekomandimit 8 dhe publikimi i udhëzimit të rishikuar “*nuk lënë hapësirë për zbatimin e masave që nuk janë në proporcion me rreziqet e vlerësuara të financimit të terrorizmit dhe për këtë arsye janë tepër penguese ose kufizuese për sektorin jofitimprurës*”. ([citim në faqen e internetit të FATF](#))

Tani, FATF do të punojë për të rishikuar pjesët përkatëse të Metodologjisë së saj për raundin e ardhshëm të vlerësimeve të ndërsjella. Në raundin tjetër, çdo vend do të vlerësohet përkundrejt këtyre standardeve të rishikuara dhe do të duhet të demonstrojë se ato po marrin një qasje të bazuar në rrezik për të parandaluar keqpërdorimin e sektorit jofitimprurës, pa ndërprerë ose dekurajuar aktivitetet bamirëse legjitime.

Ne do të vazhdojmë të advokojmë me FATF-në për ndryshime në metodologjinë dhe procedurat e FATF-së për të adresuar abuzimet, gjithashtu për të përfshirë më shumë trajnime për vlerësuesit, në mënyrë që të jenë në gjendje të adresojnë kufizimet dhe mbirregullimin gjatë proceseve të vlerësimit të vendit.

II. R8 i ndryshuar (teksti i plotë)

Vendet duhet të identifikojnë organizatat që përfshihen në përkufizimin funksional të FATF për organizatat jofitimprurëse (OJF) dhe të vlerësojnë rreziqet e tyre të financimit të terrorizmit. Vendet duhet të kenë miratuar masa të përqendruara, proporcionale dhe të bazuara në rrezik, pa ndërprerë ose dekurajuar në mënyrë të padrejtë aktivitetet legjitime të OJF-ve, në përputhje me qasjen e bazuar në rrezik. Qëllimi i këtyre masave është mbrojtja e OJF-ve të tilla nga abuzimi i financimit të terrorizmit duke përfshirë:

- organizata terroriste që paraqiten si subjekte legjitime;
- duke shfrytëzuar subjektet legjitime si mjete për financimin e terrorizmit, duke përfshirë edhe qëllimin për t'i shpëtuar masave të ngrirjes së aseteve; dhe
- duke fshehur ose mbuluar diversionin klandestin të fondeve të destinuar për qëllime legjitime për organizatat terroriste.

III. Paragrafët kryesorë në Shënimin Interpretues për R.8:

D. QASJE EFEKTIVE NË IDENTIFIKIMIN, PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E ABUZIMIT TË FINANCIMIT TË TERRORIZMIT (FT) TË OJF-ve

(a) Kontaktimi (outreach) i qëndrueshëm në lidhje me çështjet e financimit të terrorizmit – theksi vihet në kontaktimin dhe angazhimin me shoqërinë civile, duke punuar së bashku me autoritetet

- i. Vendet duhet të kenë politika të qarta për të promovuar përgjegjshmërinë, integritetin dhe besimin e publikut në administrimin dhe menaxhimin e OJF-ve.

- ii. Vendet duhet të ndërmarrin programe informuese dhe edukuese, sipas rastit, për të rritur dhe thelluar ndërgjegjësimin e OJF-ve, si dhe të komunitetit të donatorëve mbi vulnerabilitetet e mundshme të OJF-ve ndaj abuzimit të financimit të terrorizmit dhe rreziqeve të financimit të terrorizmit, si dhe masat që OJF-të mund të marrin për t'u vetëmbrojtur nga një abuzim i tillë.
- iii. Vendet duhet të punojnë me OJF-të për të zhvilluar dhe përmirësuar praktikatat më të mira që adresojnë rreziqet e financimit të terrorizmit dhe në këtë mënyrë t'i mbrojnë ato nga abuzimi i financimit të terrorizmit.
- iv. Vendet duhet të inkurajojnë OJF-të të kryejnë transaksione nëpërmjet kanaleve të rregullta financiare dhe të pagesave, kudo që është e mundur, duke pasur parasysh kapacitetet e ndryshme të sektorëve financiarë në vende dhe zona të ndryshme, dhe rreziqet e përdorimit të parasë fizike (cash).

(b) Masat e përqendruara, proporcionale dhe të bazuara në rrezik, duke përfshirë mbikëqyrjen ose monitorimin e OJF-ve – fokusi është në monitorimin proporcional, jo “një qasje të njëjtë për të gjithë” (një ligj për të gjithë). Sugjerimi është që të përdoren mekanizmat ekzistues dhe vetërregullues të sektorit për të adresuar rreziqet.

Vendet duhet të ndërmarrin hapa për të promovuar mbikëqyrjen ose monitorimin e fokusuar, proporcional dhe të bazuar në rrezik të OJF-ve. Një qasje e "njëjtë për të gjithë" nuk do të ishte në përputhje me zbatimin e duhur të një qasjeje të bazuar në rrezik, siç përcaktohet në Rekomandimin 1 të Standardeve të FATF. Në praktikë:

- i. Vendet duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë se kanë masa të përqendruara, proporcionale dhe të bazuara në rrezik që zbatohen për OJF-të. Është gjithashtu e mundur që masat ekzistuese rregullatore dhe vetërregulluese dhe masat e lidhura me kontrollin e brendshëm të OJF-ve, ose masa të tjera tashmë mund të adresojnë mjaftueshëm rrezikun aktual të financimit të terrorizmit për OJF-të në një vend, megjithëse rreziqet e financimit të terrorizmit për sektorin duhet të rishikohen periodikisht.
- ii. Autoritetet përgjegjëse duhet të monitorojnë përputhshmërinë e OJF-ve me masat e fokusuara, proporcionale dhe të bazuara në rrezik që zbatohen ndaj tyre.
- iii. Autoritetet përgjegjëse duhet të jenë në gjendje të zbatojnë sanksione efektive, proporcionale dhe bindëse për shkeljet nga OJF-të ose personat që veprojnë në emër të këtyre OJF-ve.

IV. Dokumenti i Praktikave më të Mira (DPM) -Udhëzuesi zyrtar i FATF

Përveç R.8 të rishikuar, ekziston [një dokument i ri udhëzues për zbatimin e R.8](#), që pasqyron ndryshimet e kryera dhe synon të ndihmojë në zbatimin efektiv të tij.

Dokumenti udhëzues përfshin gjithashtu shembuj të praktikave të mira dhe negative – **çfarë juridiksionet nuk duhet të bëjnë** kur zbatojnë dispozitat e R.8.

Paragrafët kryesorë në DPM:

Paragr. 32 (fq. 14) – Fokusimi në angazhimin e vazhdueshëm të shoqërisë civile gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut të vendit, si dhe përfshirja e masave vetërregulluese të sektorit në këtë proces

32. Është jetike që përpjekjet për të identifikuar OJF-të dhe për të vlerësuar rrezikun e FT-së të përfshijnë angazhimin e OJF-ve.

Është e rëndësishme të sigurohet pjesëmarrja e një kampioni përfaqësues të OJF-ve në procesin e vlerësimit të rrezikut, duke marrë parasysh faktorë të tillë si madhësia e subjekteve, kapacitetet organizative, natyra e veprimtarisë dhe diversiteti i pjesëmarrësve, dhe, kur është e nevojshme, përfaqësues që kanë njohuri të besueshme mbi OJF-të e peregjistruara ose të palicensuara.

Për të siguruar përfshirjen e të gjithë grupeve përkatëse të OJF-ve, agjencia koordinuese duhet të bëjë çdo përpjekje për të arritur sa më shumë organizata të ndryshme që të jetë e mundur, për shembull duke administruar anketa dhe pyetësorë online dhe duke u lidhur me organizatat ombrellë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në juridiksione ku shumë aktivitete të OJF-ve janë të peregjistruara ose të palicensuara, ose ndodhin përtej kompetencave të autoriteteve.

Në vendet ku janë krijuar organizata vetërregulluese që monitorojnë ose ofrojnë certifikim të caktuar për anëtarët e tyre, këto duhet të përfshihen gjithashtu në vlerësimin e rrezikut. Krijimi i një marrëdhënieje të shëndetshme, të vazhdueshme produktive pune me një seksion përfaqësues të sektorit është shumë e rëndësishme për suksesin e ushtrimit të vlerësimit të rrezikut.

Paragr. 34 (fq. 15) – përdorimi i burimeve përkatëse të informacionit – i rëndësishëm nëse shoqëria civile dëshiron të dërgojë informacion tek FATF/vlerësuesit e vendit përpara vlerësimit të ndërsjellë të vendit

34. Dokumentet dhe raportet e besueshme vendase dhe ndërkombëtare që mund të ofrojnë burime të rëndësishme informacioni përfshijnë:

- Raportet hetimore ose rastet ligjore;
- Raportet e transaksioneve të dyshimta;
- Vlerësimet rajonale ose lokale të rrezikut të FT-së nga qeveria, sektori i OJF-ve dhe sektori privat;
- Raportet e inteligjencës vendase dhe të jashtme;
- Auditimet ligjore;
- Raportet e organeve mbikëqyrëse ose të organizatave vetërregulluese;
- Raste studimore dhe raporte nga OJF-të;
- Raportet nga organizatat ndërqeveritare;
- Publikimet e institucioneve financiare; etj.

Paragr. 42 (fq. 17) – zbutja e rreziqeve të financimit të terrorizmit – vendet duhet së pari të shikojnë masat ekzistuese, gjithashtu vetërregullimin e sektorit të shoqërisë civile, përpara se të hartojnë rregullore të reja

42. Përpara vendosjes së masave zbutëse për të adresuar rreziqet e FT-së, vendet mund të marrin në konsideratë masat ekzistuese brenda OJF-ve, duke përfshirë masat ligjore, rregullatore, fiskale, administrative, masat politike nga qeveria (duke përfshirë kontaktimin me sektorin) dhe kapacitetin kombëtar të luftës kundër financimit të terrorizmit në përgjithësi. Vendet duhet të marrin në konsideratë, aty ku ekzistojnë, masat vetërregulluese të qeverisjes dhe transparencës dhe masat e brendshme për zbutjen e rrezikut në nivel sektori dhe organizativ. Masat ekzistuese për parandalimin dhe zbutjen e rreziqeve të tjera dhe aktiviteteve të paligjshme mund të adresojnë mjaftueshëm rrezikun e FT-së me të cilin përballen OJF-të, ndërsa masa shtesë ose të ndryshme mund të merren parasysh kur masat ekzistuese vlerësohen të papërshtatshme për të zbutur rrezikun, ose konsiderohen si rrezik i FT-së për sektorin, që evoluon dhe ndryshon me kalimin e kohës.

Paragr. 45 (fq. 17) – vendet duhet të marrin në konsideratë ndikimin negativ të masave të tyre tek shoqëria civile

45. Vendet duhet të kenë parasysh ndikimin e mundshëm të masave në aktivitetet legjitime të OJF-ve dhe t'i zbatojnë ato, vetëm në ato raste kur janë të nevojshme, vetëm për të zbutur rreziqet e vlerësuara.

R.8 pranon shprehimisht se masat e marra për mbrojtjen e OJF-ve nuk duhet të pengojnë ose dekurajojnë në mënyrë të padrejtë aktivitetet legjitime të OJF-ve. Kjo nënkupton që, për shembull, këto masa nuk duhet të kufizojnë ose vonojnë në mënyrë të padrejtë ose pa dashje aftësinë e një OJF-je për të aksesuar ose transferuar burime për të kryer aktivitetet e saj legjitime. Përkundrazi, masa të tilla duhet të nxisin transparencën dhe të krijojnë besim më të madh në sektor, në gjithë komunitetin e donatorëve, institucionet financiare dhe tek publiku i gjerë, që fondet dhe shërbimet e bamirësisë po arrijnë tek përfituesit e tyre legjitimë.

Paragr. 46 (fq. 17) – sqaron se organizatat e shoqërisë civile nuk janë subjekte raportuese dhe nuk duhet të kryejnë procesin e kujdesit të duhur ndaj klientit

46. R.8 nuk kërkon ose synon që vendet të caktojnë ose mbikëqyrin OJF-të si subjekte raportuese. Rekomandimet e FATF nuk kërkojnë që OJF-të të kryejnë kujdesin e duhur ndaj klientit (“CDD”), as nuk kërkojnë që OJF-të të ndërmarrin masa të tjera parandaluese, si zbulimi dhe raportimi i aktiviteteve të dyshimta, sipas Rekomandimit 20.

Në të vërtetë, ndryshe nga Institucionet Financiare dhe Bizneset dhe Profesionet e Përcaktuara Jofinanciarë, OJF-të nuk kanë klientë të cilëve u ofrojnë shërbime; ata kanë donatorë, fondet e të cilëve shkojnë për zhvillimin e aktiviteteve të OJF-ve. Në thelb, kjo marrëdhënie është e ndryshme.

Paragr. 47 (fq. 18) – vendet duhet të respektojnë ligjin dhe detyrimet aktuale ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtat e njeriut, në veçanti liritë qytetare (organizimi, tubimi, liria e shprehjes)

47. Pajtueshmëria me Rekomandimet e FATF nuk duhet të jetë në kundërshtim me detyrimet e një vendi sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe ligjeve ndërkombëtare, në veçanti, ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, ligjit ndërkombëtar për refugjatët dhe ligjit ndërkombëtar humanitar (shih gjithashtu paragrafin 8). Zbatimi i R.8 duhet të vëzhgojë dhe respektojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si liria e mendimit, shprehjes, fesë ose besimit, liria e tubimit paqësor dhe e organizimit. Për shembull, paragrafi 23 i Rezolutës 2462 (2019) së Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) inkurajon shtetet anëtare të punojnë në bashkëpunim me sektorin jofitimprurës për të parandaluar abuzimin e organizatave të tilla, duke përfshirë organizatat e frontit nga dhe për terroristët, duke kujtuar se shtetet duhet të respektojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, dhe rikujton rekomandimin përkatës dhe dokumentet udhëzuese ekzistuese të FATF-së në lidhje me këtë, në veçanti rekomandimin e saj 8 (shih gjithashtu Preambulën e Rezolutës 2129 (2013) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së).

Përveç kësaj, Rezoluta 2664 (2022) e Këshillit të Sigurimit të OKB-së parashikon një përjashtim humanitar për dispozitat e ngrirjes së aseteve të regjimeve të sanksioneve të OKB-së.

Paragr. 48 (fq. 18) – fokusohet në listën e mundshme të masave që vendet mund të marrin, duke paralajmëruar se kjo nuk duhet replikuar në çdo vend dhe jo për të gjitha organizatat e shoqërisë civile

48. Masat e parashikuara në Kutinë 3 janë disa shembuj të masave që vendet mund të vendosin t'i zbatojnë për OJF-të, në përputhje me një qasje të bazuar në rrezik. Masat mund të zbatohen për të gjitha OJF-të ose për një grup specifik OJF-sh tërësisht ose pjesërisht, sipas nevojës dhe në propocion me rreziqet me të cilat përballen.

Shembujt e kutisë së paragrafit 48 listojnë praktikatat negative – shembuj se çfarë NUK duhet të bëjnë vendet

Përkundrazi, masat e parashikuara në Kutinë 4 janë disa shembuj masash që nuk janë në përputhje me kërkesat e R.8. Për të shmangur çdo pasojë të padëshiruar të zbatimit të standardeve të FATF, vendet duhet të kenë masa të fokusuara, proporcionale dhe të bazuara në rrezik për OJF-të.

Paragr. 52 (fq. 21) – fokusi është në detyrimet e vendit për të bërë ndërgjegjësimin dhe edukimin e shoqërisë civile

52. Vendet duhet të ndërmarrin programe informuese dhe edukuese sipas nevojës për të rritur ndërgjegjësimin midis OJF-ve, si dhe komunitetit të donatorëve për dobësitë e mundshme të OJF-ve ndaj abuzimit me FT-në, rreziqet e TF-së, dhe masat që OJF-të mund të marrin për t'u mbrojtur nga një abuzim i tillë.

Koordinimi i vazhdueshëm ndërmjet organeve mbikëqyrëse dhe autoriteteve të tjera qeveritare për angazhimin e tyre me OJF-të siguron **dërgimin e mesazheve të qarta mbi pritshmëritë për menaxhimin e rrezikut të FT-së**. Disa nga tiparet e një sistemi të mirë-koordinuar të komunikimit ndërmjet agjencive dhe OJF-ve mund të përfshijnë shkëmbimin e rregullt të informacionit, edukimin dhe kontaktim me, dhe në të gjithë sektorin e OJF-ve. Kjo mund të ndodhë në kontekstin e një partneriteti publik privat me shumë aktorë.

Paragr. 54 (fq. 22) – Përqendrimi është në angazhimin dhe konsultimin me shoqërinë civile në lidhje me masat e zbutjes, legjislacionin dhe rëndësinë e dialogut të vazhdueshëm

54. Vendet duhet të punojnë me OJF-të për të zhvilluar dhe përmirësuar praktikat më të mira për trajtimin e rreziqeve të FT-së dhe në këtë mënyrë t'i mbrojnë ato nga abuzimi i FT-së. Tipologjitë e FT-së evoluojnë shumë shpejt dhe sektori i OJF-ve duhet të jetë në gjendje t'i zbulojë këto ndryshime dhe të informojë autoritetet. Autoritetet duhet të mbajnë **dialog të vazhdueshëm dhe të rregullt me sektorin jofitimprurës** për të qenë të qartë dhe të përditësuar rreth rreziqeve, të kuptojnë masat vetërregulluese dhe masat e kontrollit të brendshëm të OJF-ve, për të zhvilluar një përgjigje të duhur politike (shiko 2.1.3 dhe 2.1.4). Kjo mund të jetë në formën e forumeve, konferencave ose grupeve të konsultimit midis një sërë agjencish qeveritare (për shembull organet mbikëqyrëse, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe AIF¹) dhe një sërë pjesëmarrësish nga sektorët e OJF-ve (shiko Kapitullin 4 mbi dialogun shumëpalësh).

Institucionet financiare gjithashtu mund të përfshihen në këto aktivitete, për të kontribuar në identifikimin e tipologjive dhe praktikave më të mira për të adresuar abuzimin e FT-së të OJF -ve. Kjo ofron një mundësi për të diskutuar rreziqet, udhëzimet ose zhvillimet e tjera të politikave. Edhe pse qëllimi kryesor i këtyre aktiviteteve nuk është pasja e një reagimi specifik për kategori të caktuara OJF-sh, ato mund të ndihmojnë për të rritur ndërgjegjësimin rreth sfidave dhe përgjigjeve të përbashkëta për adresimin e tyre.

Paragr. 58 (fq. 23) – mbikëqyrja dhe monitorimi i vendit duhet të jetë proporcional dhe i fokusuar – duke përfshirë edhe shembuj se çfarë NUK duhet të bëjnë vendet (shih kutinë faqe 24)

58. Autoritetet përgjegjëse duhet të mbikëqyrin ose monitorojnë pajtueshmërinë e OJF-ve me masat e fokusuara, proporcionale dhe të bazuara në rrezik që zbatohen ndaj tyre. Konceptet e "mbikëqyrjes" dhe "monitorimit" përfshijnë një spektër aktivitetsesh dhe mjetesh në dispozicion të mbikëqyrësve që duhet të zbatohen përmes qasjes së bazuar në rrezik.

¹ Agjencia e Inteligjencës Financiare

Shtojca A – shembuj të praktikave të mira nga qeveritë dhe sektori i shoqërisë civile

Vende të ndryshme paraqesin shembujt e tyre, ashtu si dhe shoqëria civile. Është e rëndësishme të lexohen të gjithë këto, nga ata që kanë një lente specifike për kontekstin (duke vënë në dukje se jo të gjitha organizatat do të pajtoheshin me shembujt e mirë të paraqitur nga vendet) dhe të mos përdoren këta shembuj si sugjerime ose udhëzime specifike “copy-paste”.

European Center for Not-for-Profit Law Stichting
5 Riviervismarkt, 2513 AM, The Hague, Netherlands

www.ecnl.org

twitter.com/enablingNGOlaw



European Center for
Not-for-Profit Law

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate, kati i 10, Ap. 71 / 73, Tiranë, Shqipëri

www.partnersalbania.org

[f](#) [@](#) [in](#) [X](#) [@partnersalbania](https://twitter.com/partnersalbania)



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM